



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 86 Më 14.01.2020
Br. prot. Dt. 20
RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim

Odeljenje za Zastitu i Spasavanje

Department for Protection and Rescue

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2020

Gjatë vitit 2020 në DMSH janë zhvilluar aktivitete si më poshtë:

Gjashtë mujori i parë: janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor

- Si drejtor kam qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje dimërore dhe verore të rrugëve në komunën tonë, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kemi qenë tërë kohën në terren, në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare së bashku me trotualet janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuar ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorëve.
- Si drejtor poashtu kam qenë i angazhuar tërë vitin në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriqimit publik, kemi arritur të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriqim publik.
- Janë inspektuar lumenjtë, përockat dhe kanalet e hapura dhe pas inqizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përockave etj.
- Me ngritjen e shtabit emergjent të komunës me vendim të kryetarit për menaxhimin e situatës me virusin COVID-19, në njësinë e zjarrfikjes është bërë mobilizim i brendshëm dhe është ngritur niveli i gatishmërisë.
- Përmes drejtorisë së shëndetësisë është bërë dezinfektimi i të gjitha hapësirave në ndërtesën e zjarrfikjes dhe poashtu është bërë dhe dezinfektimi i kamionave dhe paisjeve për intervenim.
- Me vendim të kryetarit jam caktuar pjesë e komisionit për shpërndarjen e ndihmave për familjet në nevojë, së bashku me antarët e tjerë të këtij komisioni gjatë tërë kohës së pandemisë COVID-19 kemi bërë shpërndarjen e këtyre ndihmave, ky komision vazhdon ende të jetë aktiv.
- Pas shpërthimit të zjarreve në bjeshkët e komunës sonë, saktësisht në trekufirshin Rahovec-Suharek-Malishevë e gjithë njësia e zjarrfikjes ishte në mobilizim të brendshëm nga data 19-22.03 kemi qenë vazhdimisht në intervenim deri sa është arrit të shuhet plotësisht zjarri.
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve (Konform Planit të punës së drejtorisë);
- Angazhim të rregullt në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Është bërë servisimi i të gjitha aparateve për shuarjen e zjarreve (Konform Planit të punës së drejtorisë).

Gjashtë mujori i dytë: korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor

- Konform planit vjetor të drejtorisë kemi zhvilluar një fushatë vetëdijësuese për mbrojtje nga zjarri, nëpër të gjitha vendbanime të komunës sonë kemi shpërndarë disa fletushka që do të i ndihmojnë qytetarëve për parandalim dhe mbrojtje nga zjarri.
- Gjatë sezonës së nxehtë të vitit nuk kemi pasur numër të madh të zjarreve në fusha dhe male, përjashtimisht disa raste por që fatmirësisht i kemi kontrolluar mirë.
- Me vendim të Kryetarit të komunës jam caktuar meanxher i kontratës për Ndërtimin e rrugëve lokale me kubëza- Lot 2.
- Kemi blerë paisje të punës për stafin e zjarrfikësve (Konform Planit të punës së drejtorisë).
- Kemi nënshkruar një kontratë të re për Servisim të Aparatave kundër Zjarrit.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera të NJPZSH-së në Rahovec për periudhën kohore: JANAR- DHJETOR 2020.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2020														
2020	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	17	17												34
Shkurt	20	19			1				2	2				44
Mars	17	17												34
Prill	29	28	1											58
Maj	13	6	2	2	1	2								26
Qershor	6	5		1										12
Korrik	30	27	3											60
Gusht	20	17			3									40
Shtator	21	18		1	1	1								42
Tetor	6	2		2	1	1								12
Nëntor	6	4	1	1										12
Dhjetor	14	13			1									28
Gjithsejtë	199	173	7	7	8	4			2	2				402

14.01.2020

Rahovec



Drejtore i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

Hasan Përboqi